VENDIM
Nr. 19, datë 21.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Blerina Basha, më datë 19.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (Dh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Dhionisios Alfred Beleri, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Adnan Xholi dhe Dorina Bejko, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 46, datë 22.5.2023, të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë; nr. 19, datë 1.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 17, 18, 20, 22, 27, 28, 30, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 3 i Protokollit shtesë të saj; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN**:**

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri *(kërkuesi)* ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.5.2023.

2. Dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve, më datë 12.5.2023, kërkuesi dhe një person tjetër janë arrestuar në flagrancë si të dyshuar për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Me vendimin nr. 205, datë

13.5.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*gjykata e rrethit*), ndër të tjera, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka deklaruar moskompetencën e saj, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë (*GJKKO e Shkallës së Parë*), si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

3. Më datë 14.5.2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe me vendimin nr. 194, datë 16.5.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 ka shpallur kërkuesin fitues. Në vijim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*KQZ*), me vendimin nr. 611, datë 25.5.2023, ka vendosur dhënien kërkuesit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.

4. Ndërkohë, për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme masa shtrënguese e sigurimit personal e vendosur ndaj kërkuesit nga gjykata jokompetente e rrethit, për të cilën është kërkuar vazhdimi i zbatimit, i është nënshtruar shqyrtimit tashmë nga gjykata kompetente sipas përcaktimit të nenit 88 të KPP-së. Me vendimin nr. 46, datë 22.5.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg". Sipas asaj gjykate, plotësohej kushti i përgjithshëm i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se kërkuesi ka konsumuar veprën penale (neni 228, pika 1, i KPP-së), sikundër në mënyrë kumulative plotësohen edhe kushtet e veçanta të caktimit të masës së sigurimit personal (neni 228, pika 3, i KPP-së). Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, vepra penale e cila dyshohet se është konsumuar nga personat nën hetim paraqet rrezikshmëri shoqërore të theksuar. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke mbajtur në konsideratë shkallën e dënimit të parashikuar nga dispozita ligjore konkrete për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i KP-së, marrëdhënien juridike që preket, dyshimin se vepra është kryer në bashkëpunim, duke rritur rrezikshmërinë shoqërore, si edhe personalitetin e personave nën hetim, ka vlerësuar se masa e sigurimit personal më e përshtatshme është ajo "Arresti në burg". Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke pretenduar se nuk ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal, përveç se masa shtrënguese e vendosur ndaj tij është e papërshtatshme.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 1.6.2023, ka vendosur të miratojë vendimin nr. 46, datë 22.5.2023. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, në rastin e kërkuesit plotësohen kumulativisht kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal sipas nenit 228 të KPP-së. Po kështu, sipas asaj gjykate, plotësohen kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase sigurimi personal dhe se masa e sigurimit duhet të ketë karakter paraburgosës, në mënyrë që të pamundësojë njëherazi helmimin e provave, rrezikun e ikjes dhe atë të kryerjes së veprave penale të tjera në bashkëpunim ndaj shtetit. Në këto kushte, GJKKO-ja e Apelit, bazuar në nenin 230 të KPP-së, ka arsyetuar se në kushtet kur nuk është në gjendje të sigurojë efektivisht dhe konkretisht asnjë masë tjetër sigurimi veç asaj "Arresti në burg", ka vlerësuar se masa e sigurimit personal më e përshtatshme për kërkuesin është "Arresti në burg", e parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi, i cili ka pretenduar se vendimet e GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe GJKKO-së së Apelit bien në kundërshtim me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe KPP-në, duke pretenduar sërish se nuk ekzistojnë kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal, përveç se masa shtrënguese e vendosur ndaj tij është e papërshtatshme.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.7.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 19, datë 1.6.2023, të GJKKO-së së Apelit. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë arsyetuar drejt dhe mjaftueshëm në lidhje me plotësimin kumulativisht, në rastin e kërkuesit, të kushteve për caktimin e masës së sigurimit personal dhe se për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të tij, nevojat e sigurimit në rastin konkret mund të kryhen vetëm nëpërmjet masës shtrënguese të sigurimit personal "Arresti në burg".

7. Më datë 28.9.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 13.10.2023 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 23.10.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se procesi gjyqësor për caktimin e masës së arrestit ndaj tij ka cenuar:

8.1 *Parimin e ushtrimit të sovranitetit të popullit dhe të drejtën për t'u zgjedhur, lirinë e shprehjes, lirinë personale, të drejtën për jetë familjare, të lidhur me parimin e proporcionalitetit,* pasi ndjekja penale dhe arrestimi i tij është bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*Prokuroria Vlorë*), e cila nuk ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore për regjistrimin e procedimit penal dhe në vijim për kryerjen e veprimeve hetimore, duke vepruar në kundërshtim me nenin 75/a të KPP-së. Procedimi penal ndaj kërkuesit ka qenë i ndikuar nga Kryeministri. Masa e sigurimit "Arresti në burg" nuk është proporcionale në raport me nevojat e hetimit, interesin publik që kërkohet të mbrohet dhe gjendjen që e ka shkaktuar, pasi vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi dënohet me burgim deri në 5 vjet. Interpretimi i gabuar i dispozitave të ligjit procedural nga gjykatat ka sjellë cenimin e të drejtave kushtetuese të tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e mbështet arsyetimin në një ngjarje të 20 vjetëve më parë, duke mohuar edhe evolucionin e njeriut dhe të drejtën e tij për t'iu harruar e shkuara kur kalojnë afatet e parashikuara në ligj.

8.2 *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit,* pasi ai nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me shtetas të tjerë që ndodhen në të njëjtën gjendje, duke iu referuar rastit të shtetasit E.M., kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, i cili është akuzuar për kryerjen e së njëjtës vepër penale si kërkuesi.

8.3 *Të drejtën për proces të rregullt,* në drejtim të:

8.3.1 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi arsyetimi i gjykatave është jashtë fushës së vlerësimit gjyqësor, si dhe i pabazuar në prova edhe për faktin se procedimi penal nuk ka filluar me kallëzim, por me referim të Policisë Gjyqësore. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatave është kontradiktor dhe ato nuk kanë marrë masa për riparimin e shkeljes së kryer ndaj kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit gabon kur arsyeton se procedimi penal është regjistruar pas kallëzimit të një shtetasi, pasi kjo nuk është e vërtetë. Arsyetimet e gjykatave janë të gabuara dhe të pabazuara në prova, pasi "autorizimi", si veprim procedural, i parashikuar në nenet 221 dhe 222 të KPP-së, nuk ankimohet me ankim të veçantë. Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, Kolegji Penal shprehet me alternativa dhe, sipas tij, kërkuesi mund të jetë i dënuar ose i rehabilituar, arsyetim që bie në kundërshtim me parashikimet ligjore për mënyrën se si i arsyeton vendimet gjykata, e cila duhet të jetë e qartë dhe duhet të përcaktojë faktin sipas provave që shqyrton dhe ligjit të zbatueshëm. Arsyetimi i Kolegjit Penal se në të njëjtin procedim ka pasur edhe një të arrestuar tjetër, është shumë i dobët, ndërkohë që gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në lidhje me cenimin e së drejtës për t`u shprehur dhe asaj për t'u zgjedhur. Kolegji Penal e ka arsyetuar vendimin e tij pa u bazuar në prova dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për përdorimin e ndjekjes penale për të favorizuar palën tjetër në garë që mbështetej nga Kryeministri. Gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit.

8.3.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme,* pasi fakti nga gjykatat është paraqitur sipas kërkesës së prokurorisë, ndërkohë që bie në kundërshtim me aktet që vetë prokuroria ka paraqitur. Fakti duhet të parashtrohet nga

gjykata, siç është vërtetuar nga provat që i janë nënshtruar debatit gjyqësor, dhe jo sipas kërkesës së njërës palë. Gjykatat kanë pranuar vetëm argumentet e prokurorisë, pa arsyetuar shkaqet ligjore se përse i kanë konsideruar të papranueshme kundërshtimet e kërkuesit. Nga aktet e prokurorisë provohet se përgjimi i kërkuesit nga policia kishte filluar përpara se kjo e fundit të njoftonte prokurorinë për ndonjë veprimtari kriminale. Provat mbi të cilat prokuroria ka mbështetur dyshimin e arsyeshëm, sipas nenit 228, pika 1, të KPP-së, janë marrë në mënyrë të paligjshme, për pasojë janë të papërdorshme. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, që pranohet nga GJKKO-ja e Apelit se është i paarsyetuar, mbështetet në deklarimet e shtetasit A.R., i cili është një person i dënuar më parë për kryerjen e veprës penale "Mashtrimi" dhe bazuar në nenin 192 të KPP-së dëshmia e tij duhej të merrej me rezerva.

8.3.3 *Parimit të paanshmërisë,* pasi gjykatat kanë përcaktuar rrethanat e faktit sipas parashtrimit të prokurorisë, pa i verifikuar ato. Ato kanë pranuar aktet e prokurorisë pa shqyrtuar kundërshtimet e kërkuesit në lidhje me ato akte, si dhe kanë dhënë opinion për mënyrën se si janë marrë provat nga prokuroria pa u mbështetur në aktet që vetë ajo ka paraqitur. Ky parim është cenuar edhe nga sjellja e gjyqtarëve në proces, shprehjet e përdorura prej tyre në vendim dhe nga fakti që kanë tejkaluar shkaqet e ankimit, duke rënduar pozitën e kërkuesit, si dhe duke favorizuar prokurorinë në vendimmarrjet e saj. Kolegji Penal duhet t'i kishte dhënë shpjegim nocionit të përdorur "fakt i pamohueshëm", duke cilësuar provat që kanë pasur forcë ta bëjnë të pamohueshëm faktin e referuar prej tij.

8.3.4 *Parimit të mosdënimit pa ligj dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë vlerësuar si rrethanë rënduese faktin që kërkuesi ka qenë i dënuar më parë, ndonëse në zbatim të nenit 69 KP-së dhe dëshmive të penalitetit të administruara nga prokuroria ai rezulton i rehabilituar. Qëndrimi i Kolegjit Penal për rrethanën rënduese që lidhet me rehabilitimin e kërkuesit, bie në kundërshtim me vetë praktikën njësuese të atij kolegji.

8.3.5 *Parimit të mosrëndimit të pozitës së kërkuesit*, çka ka sjellë edhe kufizimin e së drejtës së ankimit dhe së drejtës aksesit, pasi kërkuesi ka bërë ankim për mosarsyetimin e plotë të vendimit nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në lidhje me caktimin e masës së sigurimit, ndërsa GJKKO-ja e Apelit, pasi ka pranuar se vendimi i kundërshtuar është minimalisht i arsyetuar, ka miratuar të njëjtën masë sigurimi, duke plotësuar arsyetimin dhe rënduar pozitën e tij. Gjykatat në arsyetimet e tyre kanë dalë tej kërkimeve të prokurorisë, e cila ka pretenduar vetëm ekzistencën e rrezikut të kryerjes së veprave penale të të njëjtit lloj, sipas parashikimit të nenit 228, pika 3, shkronja "c", të KPP-së, kurse gjykatat kanë arsyetuar se ekzistojnë njëkohësisht të tria kriteret e parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së. Arsyetimi i GJKKO-së së Apelit është pranuar edhe nga Kolegji Penal, i cili ndonëse është i paqartë, përsëri nuk ka pranuar kundërshtimet e kërkuesit. Sipas arsyetimit të atij kolegji, bazuar në nenin 249 të KPP-së, gjykata e apelit mund të miratojë vendimin e masës së sigurimit edhe me arsyetim të ndryshëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë, arsyetim ky që bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 425 të KPP-së.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1 Pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u zgjedhur* dhe *parimit të ushtrimit të sovranitetit të popullit* janë të pabazuara, pasi kufizimi i lirisë së kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Kushtetutës. Paraqitja e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" duhet të konsiderohet si ushtrim legjitim i organit të akuzës dhe i pushtetit gjyqësor, me qëllim përmbushjen e interesit kushtetues që parashikon garantimin e nevojës për zhvillimin e procesit të rregullt e të drejtë ligjor. E drejta për të ushtruar funksionin e kryetarit të bashkisë nuk mund të konsiderohet si mbizotëruese në raport me përmbushjen e interesit kushtetues, e cila ka të bëjë me plotësimin e nevojave për mbarëvajtjen e procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor që synon përcaktimin e së vërtetës lidhur me akuzat e ngritura dhe çështjen penale në përgjithësi.

9.2 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i pabazuar, pasi ky i fundit i ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre, sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

9.3 Pretendimi se *ndjekja penale nuk është bërë nga organi kompetent,* ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat dhe ajo është bërë në përputhje me nenet 28 dhe 29 të KPP-së. Në rastin konkret ka ekzistuar rrethana e ngutshmërisë, e cila lidhet me faktin se afati për hetimin e krimit zgjedhor të dyshuar nga prokuroria është i shkurtër, referuar datës së afërt të zgjedhjeve dhe faktit se hetimi proaktiv nga natyra e tij është dinamik dhe nuk lejon pritjen e kryerjes së hetimit nga prokuroria tjetër.

9.4 Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe mënyrën e marrjes së provave* janë të pabazuara. Kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij në gjykim, ka paraqitur të gjitha provat dhe argumentet për kundërshtimin e kërkesës së prokurorisë. Gjykatat nuk e kanë vënë kërkuesin në pozita më pak të favorshme se organi i akuzës, për sa kohë që i kanë marrë në shqyrtim të gjitha provat dhe argumentet e paraqitura prej tij. Bindja e gjykatave është formuar nga vlerësimi i provave të paraqitura nga të dyja palët në gjykim. Interpretimi i gjykatës së apelit në lidhje me ankimin ndaj vendimit që pranon përgjimin është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat procedurale. Në këtë fazë të gjykimit, për caktimin e masave të sigurimit personal, aplikohet një standard provueshmërie më i ulët se sa ai përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, karakteristikë e shqyrtimit të çështjes në themel. Në këtë të fundit, të gjitha provat do t'i nënshtrohen vlerësimit gjyqësor dhe do të konkludohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për vlefshmërinë e tyre dhe, për rrjedhojë, në përdorimin e të dhënave të përftuara prej tyre. Pretendimet e kërkuesit për paligjshmërinë dhe papërdorshmërinë e përgjimeve janë shqyrtuar dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

9.5 Edhe pretendimet për cenimin *e parimit të barazisë përpara ligjit* janë të pabazuara, pasi të qenët përfaqësues i një pakice nuk mund të institucionalizojë shkeljen e ligjit dhe kryerjen e veprimeve kriminale. Pretendimi për trajtim jo të barabartë, në raste të ngjashme, nuk është argument i bazuar për ndryshimin e masës së sigurimit. Në rastin konkret, janë vlerësuar drejt kriteret e përgjithshme për caktimin dhe përzgjedhjen e masës së sigurimit personal.

9.6 Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument bazuar në jurisprudencën kushtetuese dhe nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë paanshmërinë personale (subjektive) të gjyqtarëve. Mënyra e vlerësimit të provave ose e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat, jo vetëm që nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, por nuk është as e mjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim.

9.7 Të pabazuara janë edhe pretendimet për *rëndimin e pozitës* dhe të *dënimit pa ligj*. GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit kanë vlerësuar njësoj, duke vërejtur në rastin konkret ekzistencën e tre kushteve të përcaktuara në nenin 228, pika 3, të KPP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat ligjore në lidhje me institutin e "*rehabilitimit*". Me të drejtë gjykatat kanë vlerësuar se kërkuesi ka rrezik për t'u larguar, ashtu edhe për të kryer krime të tjera, pasi rezulton se ai i është shmangur më parë një tjetër dënimi penal të caktuar ndaj tij. Gjithashtu, gjykatat kanë vlerësuar drejt kur kanë arsyetuar se kërkuesi paraqet rrezik që mund të intimidojë dëshmitarët e ardhshëm ose të kontribuojë në prishjen e provave.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.3.2022; nr. 14, datë 11.3.2022; nr. 29, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet që vendosin masën e sigurimit personal "Arresti në burg", duke qenë se lidhen me heqjen e lirisë së individit, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.7.2012; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata konstaton se objekt i ankimit kushtetues janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal "Arresti në burg". Duke qenë se këto vendime kanë sjellë privimin e lirisë së kërkuesit, i cili është duke vuajtur aktualisht këtë masë, ato konsiderohen përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe në këtë kuptim kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara të cenuara, ndaj konsiderohet se plotësohet edhe kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive.

14. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 25.7.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datë 28.9.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se kufizimi i lirisë së tij është bërë për arsye politike dhe për të mbështetur kandidatin e propozuar nga shumica qeverisëse. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi qëndrimi i prokurorisë dhe i gjykatave në një çështje të ngjashme ka qenë i ndryshëm, duke iu referuar, konkretisht, rastit të shtetasit E.M., kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, i cili është akuzuar për kryerjen e së njëjtës vepër.

16. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë përpara ligjit nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me diskriminimin e pretenduar për shkaqe politike, kërkuesi u është referuar deklaratave të bëra nga Kryeministri gjatë zhvillimit të fushatës elektorale në emisione të ndryshme televizive në drejtim të kërkuesit si kandidat i një force tjetër politike. Gjykata vëren se ato deklarata janë bërë në kontekst të aktiviteteve politike të subjekteve zgjedhore garuese në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, por që gjithsesi ato datojnë përpara fillimit të procedimit penal ndaj kërkuesit, sikundër edhe përpara procesit gjyqësor të kundërshtuar nga ai. Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument ose provë për ndikimin që ai pretendon se ato deklarata kanë pasur në ushtrimin ndaj tij

të ndjekjes penale, pra lidhjen mes atyre deklaratave dhe procesit penal të kundërshtuar. Vetëm fakti se kërkuesi ka garuar si kandidat i një subjekti zgjedhor kundërshtar me subjektin zgjedhor të cilit i përket Kryeministri, nuk mund të provojë *apriori* se procesi penal i zhvilluar nga organet e drejtësisë, sipas kompetencave të tyre kushtetuese, është i motivuar politikisht dhe, në këtë kuptim, kërkuesi është diskriminuar për arsye politike. Gjykata vlerëson se një rrethanë e tillë kërkon rritjen e kujdesit të nevojshëm në ushtrimin e kompetencave të tyre nga autoritetet e drejtësisë për trajtimin e rastit, por se e vetme ajo rrethanë nuk është e aftë të provojë diskriminimin për arsye politike të kërkuesit. Pranimi i së kundërtës do të sillte kufizim të papranueshëm të kompetencave kushtetuese të organeve të drejtësisë dhe, për pasojë, do të cenonte parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, si dhe atë të shtetit të së drejtës që është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor.

17. Në lidhje me diskriminimin, për shkak të mënyrës se si gjykatat kanë vendosur në një rast tjetër të ngjashëm, Gjykata thekson se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta.

18. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese pretendimet e tij në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi gjykatat në arsyetimet e tyre kanë dalë jashtë kërkimeve të prokurorisë, e cila në kërkesën e saj për caktimin e masës së sigurimit ka pretenduar vetëm ekzistencën e rrezikut të kryerjes së veprave penale të të njëjtit lloj, sipas parashikimit të nenit 228, pika 3, shkronja "c", të KPP-së, ndërkohë gjykatat kanë arsyetuar se ekzistojnë njëkohësisht të tria kriteret e parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 425 të KPP-së.

20. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se neni 425 i KPP-së bën pjesë në titullin VIII të tij, që rregullon ankimet, i cili renditet pas atij që rregullon gjykimin e çështjes në shkallë të parë. Kreu II i këtij titulli bën fjalë për apelin dhe dispozita në fjalë rregullon kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, duke parashikuar se kjo gjykatë e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ankimit. Nga ana tjetër, masat e sigurimit gjejnë rregullim në titullin V të KPP-së. Kreu I i këtij titulli rregullon masat e sigurimit personal, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal dhe përcaktohen këto të fundit. Ndërsa kreu II i këtij titulli rregullon caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, ku neni 244 përcakton se masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit (*pika 1*) dhe se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se sa ajo e kërkuar nga prokurori (*pika 3*), neni 245 rregullon vendimin e gjykatës. Ndërkohë, neni 249 rregullon ankimin kundër masave të sigurimit, ku në pikën 6 të saj parashikohet se gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se neni 425 i KPP-së në rastin konkret nuk gjen zbatim, ndërsa ankimi kundër masave të sigurimit dhe shqyrtimi i tij rregullohen në një dispozitë tjetër të veçantë të këtij kodi, në nenin 249. Nisur nga pretendimi i kërkuesit për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit, për sa i përket masës së sigurimit personal, ky parim gjen rregullim në nenin 244 të KPP-së, sipas të cilit gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se sa ajo e kërkuar nga prokurori. Në këtë kontekst, nëse prokurori nuk ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, gjykata më e lartë nuk mund të caktojë, mbi ankimin e të pandehurit ose të personit nën hetim, një masë sigurimi më të rëndë. Gjithsesi, nisur nga natyra e këtij vendimi, që

prek lirinë e personit, gjykata më e lartë nuk është e kufizuar në shqyrtimin e çështjes. Motivet për vendimmarrjen e saj mund të bazohen edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar në ankim ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të ankimuar, por gjithsesi jo përtej provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes.

21. Për sa më lart, në lidhje me këtë pretendim (cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit), Gjykata konstaton se në rastin konkret prokurori ka kërkuar që ndaj kërkuesit të caktohet masa shtrënguese e sigurimit personal "Arresti në burg", masë e cila është pranuar nga gjykata. Çështja është shqyrtuar nga gjykata e apelit mbi ankimin e kërkuesit, e cila ka miratuar masën e caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se gjykatat nuk duket të kenë vepruar në mosrespektim të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Vlen të theksohet se, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, për sa u përket kushteve të veçanta të caktimit të masës të sigurimit personal, prokurori ka pretenduar ekzistencën e tre kushteve të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, që lidhen me rrezikun që paraqet kërkuesi për marrjen ose vërtetësinë e provës, rrezikun që ai mund të largohet dhe rrezikun që mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj. Të njëjtat rreziqe janë pranuar se ekzistojnë edhe nga gjykatat, ndaj, edhe në këtë kuptim, nuk duket të kenë vepruar në mosrespektim të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Për rrjedhojë, gjykatat e zakonshme nuk kanë caktuar dhe zbatuar ndaj kërkuesit ndonjë masë sigurimi më të rëndë se sa ajo e kërkuar nga prokurori ose nga ajo e caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe as të kenë dalë jashtë kërkimeve të organit të akuzës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

22. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata vëren se, në thelb, ai ka pretenduar cenimin e lirisë personale për shkak të caktimit ndaj tij të masës së sigurimit personal "Arresti në burg", dhe, për pasojë, së drejtës për t'u zgjedhur, pasi është vënë në pamundësi që të paraqitet personalisht për kryerjen e betimit si kryetar i Bashkisë Himarë, i dalë fitues nga zgjedhjet vendore të vitit 2023, pra në pamundësi të ushtrimit të këtij mandati të fituar. Po kështu, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore objekt kërkese edhe në drejtim të garancive që ofron e drejta për proces të rregullt, duke pretenduar cenimin e parimeve të barazisë së armëve, mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, paanshmërisë, mosdënimit pa ligj, sigurisë juridike dhe mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Referuar argumenteve të kërkuesit në lidhje me këto pretendime (për proces të rregullt), Gjykata vëren se edhe pse ai u ka vënë atyre emërtime të ndryshme, në thelb, argumentet që ai ka sjellë në mbështetje të tyre kanë të bëjnë me mënyrën e arsyetimit të gjykatave. Duke mbajtur në konsideratë këto pretendime, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia*, çmon t`i analizojë ato në drejtim të kufizimit të lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur sipas neneve 27 dhe 45 të Kushtetutës, në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas neneve 17 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar në thelb se gjatë procesit për vendosjen ndaj tij të masës së sigurimit personal, gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor dhe se masa e sigurimit "Arresti në burg" nuk është proporcionale në raport me nevojat e hetimit, interesin publik që kërkohet të mbrohet dhe gjendjen që e ka shkaktuar, pasi vepra penale për të cilën akuzohet ai dënohet me burgim deri në 5 vjet. Sipas kërkuesit, gjatë procesit për vendosjen ndaj tij të masës së sigurimit personal, gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, me anë të të cilit i kanë cenuar edhe të drejtën për t'u zgjedhur, për shkak të kufizimit të lirisë personale. Si pasojë e vendosjes së masës së sigurimit "Arresti në burg", kërkuesi është vënë në pamundësi që të paraqitet personalisht për kryerjen e betimit si kryetar i Bashkisë Himarë, i dalë fitues nga zgjedhjet vendore të vitit 2023, për rrjedhojë në pamundësi të ushtrimit të këtij mandati të fituar.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kufizimi i lirisë së kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Kushtetutës. Sipas këtij subjekti, paraqitja e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" dhe vendimi, për sa më sipër, duhet të konsiderohen si ushtrim legjitim i funksioneve kushtetuese të organit të akuzës dhe i pushtetit gjyqësor, me qëllim përmbushjen e interesit kushtetues që parashikon garantimin e nevojës për zhvillimin e procesit të rregullt e të drejtë ligjor. Sipas subjektit të interesuar, e drejta për të ushtruar funksionin e kryetarit të bashkisë nuk mund të konsiderohet si mbizotëruese në raport me përmbushjen e interesit kushtetues që ka të bëjë me plotësimin e nevojave për mbarëvajtjen e procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, që synon përcaktimin e së vërtetës të lidhur me akuzat e ngritura dhe çështjen penale në përgjithësi.

25. Fillimisht, Gjykata vlerëson të theksojë faktin se në kushtet që kufizimi i së drejtës për të ushtruar mandatin e kryetarit të bashkisë është bërë me vendimet gjyqësore të kundërshtuara që kanë vendosur kufizimin e lirisë personale të kërkuesit, ajo, në vijim, do ndalet në analizën dhe vlerësimin që u kanë bërë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg" të caktuar ndaj kërkuesit. Për këtë arsye, Gjykata do të vlerësojë nëse masa e vendosur ndaj tij plotëson kriterin e proporcionalitetit. Për të arritur në përfundim të drejtë në lidhje me pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të vlerësojë, për rrjedhojë, nëse kufizimi i lirisë personale të tij ka sjellë, si pasojë, edhe cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur dhe, në këtë kuptim, nëse kufizimi respekton kriteret kushtetuese.

26. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*).

27. Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Po kështu, Gjykata ka theksuar se "dyshimet e arsyeshme" për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet. bindjen që krijohet në bazë të provave të marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet (*shih vendimin nr. 19, datë 4.4.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se "Çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti (*shih S, V dhe A kundër Danimarkës, datë 22.10.2018, §74; Witold Litwa kundër Polonisë, datë 4.4.2000, §78*) dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur (*shih James Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.9.2012, §§191–195; Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 29.1.2008 §§68–74*). Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve mbi faktet e çështjes për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm do të përbënte cenim të nenit 5 §1 (c) të KEDNJ-së (*shih Stepuleac kundër Moldavisë, datë 6.11.2007, §73; Moldoveanu kundër Republikës së Moldavisë, datë 14.9.2021, §§52–57*).

29. Faktet mbi të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm për kufizimin e lirisë nuk nevojiten të jenë në të njëjtin nivel si ato mbi të cilat bazohet vendimi i dënimit ose ngritja e akuzës (*shih Merabishvili*

kundër Gjeorgjisë, datë 28.11.2017, §184). Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, Gjykata mban në konsideratë kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih Ibrahimov and Mammadov kundër Azerbajxhanit, datë 25.8.2020, §§113–131*).

30. Po kështu, GJEDNJ-ja ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar paraburgimin: a*)* rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do paraqitej përpara gjykatës; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmerrte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §88; Tiron kundër Rumanisë, datë 7.4.2009, §37; Smirnova kundër Rusisë, datë 24.7.2003, §59*). Për sa i përket rrezikut të largimit, sipas GJEDNJ-së, ai duhet të vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal (*shih Becciev kundër Moldavisë, datë 4.10.2005, §§58–59*). Rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale është një ndër shkaqet që mund të bindin autoritetet gjyqësore që të vendosin dhe lënë në paraburgim një të dyshuar. Megjithatë është e nevojshme që rreziku të jetë i besueshëm nën dritën e rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit. Dënimet e mëparshme mund të shërbejnë si shkas për të besuar në mënyrë të arsyeshme se i akuzuari mund të kryejë vepra penale të tjera (*shih Selç'uk kundër Turqisë, datë 10.1.2006, §34; Matznetter kundër Austrisë, 10.11.1969, §9*). Sipas GJEDNJ-së, këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i autoriteteve për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip (*shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë [DhM], datë 28.11.2017, §222*). Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vendimi i saj nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 5/3 të KEDNJ-së do të merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §§89–91; McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], datë 3.10.2006, §§41–43*).

31. Lidhur me kufizimin e lirisë personale, Gjykata vëren se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, kushtet, kriteret dhe procedurat e kufizimit të saj për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Kështu, referuar kushteve të përcaktuara në nenin 228 të këtij kodi, askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova (*pika 1*) dhe ato vendosen i) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*pika 3*).

32. Për sa u përket kritereve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e tyre gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast, mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KP-ja (*pika 2*). Për sa u përket kritereve të veçanta për caktimin e masës "Arresti në burg", sipas nenit 230 të KPP-së, ajo mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit.

33. Sipas Gjykatës, kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe konkretisht me lirinë e personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Ndërsa, në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre

ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në analizë të standardeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së, të cilat evidentohen edhe në kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga dispozitat procedurale të lartpërmendura, në aspektin kushtetues, në parim, Gjykata, për të vlerësuar nëse masa e sigurimit "Arresti në burg" plotëson kriterin e proporcionalitetit duhet të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në lidhje me ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova*, si dhe të njërit prej këtyre shkaqeve: ekzistencës së *shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës* ose kur i *pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet*; ose kur për shkak të *rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të tjera*. Gjithashtu, për të arritur në përfundimin se kjo masë plotëson kriterin e proporcionalitetit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar për vendosjen e masës së sigurimit, duke mbajtur në konsideratë *kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes,* duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi, si dhe se *nëse ajo është në përpjestim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur,* pra që çdo masë tjetër është e papërshtatshme. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse këto standarde përmbushen në rastin në shqyrtim.

36. Gjykata vëren se në vlerësimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi ka konsumuar veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe plotësohen njëkohësisht dhe në mënyrë kumulative kushtet e caktimit të masës së sigurimit, të parashikuar në nenin 228 të KPP-së, për shkak të personalitetit të kërkuesit, duke qenë se ka qenë i dënuar më parë dhe ekziston rreziku real që të kryejë vepra penale më të rënda ose njësoj të rënda. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi, marzhit të dënimit të parashikuar për këtë vepër penale dhe qëndrimit të tij ekziston rreziku real që ai të largohet, duke pamundësuar zhvillimin normal të hetimit. Në përfundim të vlerësimit të kritereve të përcaktuara nga neni 228 i KPP-së, ajo gjykatë ka çmuar se për shkak të pozicionit të kërkuesit ekziston rreziku që ai të ndikojë në marrjen ose vërtetësinë e provave. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 228, pika 3, shkronjat "a", "b" dhe "c", të KPP-së (*shih faqen 21 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

37. Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë vepra penale e cila dyshohet se është konsumuar nga personat nën hetim paraqet rrezikshmëri shoqërore të theksuar. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke mbajtur në konsideratë shkallën e dënimit të parashikuar nga dispozita ligjore konkrete për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i KP-së, marrëdhënien juridike që preket, dyshimin se vepra është kryer në bashkëpunim, duke rritur rrezikshmërinë shoqërore, si edhe personalitetin e personave nën hetim, ka vlerësuar se masa e sigurimit personal më e përshtatshme është ajo "Arresti në burg" (*shih faqen 22 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

38. Analiza për plotësimin e kushteve të caktimit të masës së sigurimit personal, të parashikuara nga neni 228 i KPP-së, është bërë edhe nga GJKKO-ja e Apelit. Sipas kësaj të fundit, nga provat

e mbledhura deri në këtë fazë të hetimit, plotësohet kushti i parë i parashikuar nga kjo dispozitë, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi, në bashkëpunim, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet (*shih paragrafin 67 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Lidhur me kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ka rrethana nga të cilat krijohet vlerësimi i rrezikut eminent që liria e pakushtëzuar me masë sigurimi e kërkuesit mund të helmojë provat ose të riskojë gjetjen dhe fiksimin në gjendjen natyrore të tyre (*shih po aty paragrafin 71*). Sipas GJKKO-së së Apelit, ndaj kërkuesit ekziston rreziku për t'iu shmangur procedimit penal ose për t'u larguar nëse liria e tij personale nuk do të kufizohet dhe kushtëzohet me masë sigurimi personale, pasi edhe në një gjykim të mëparshëm penal, për të cilin është shpallur fajtor dhe dënuar me 3 vjet burgim, ai i është shmangur procedimit penal deri në pamundësimin për vite të ekzekutimit të vendimit (*po aty paragrafi 72*). Duke pasur parasysh rregullimet e nenit 69 të KP-së mbi institutin e rehabilitimit, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se mund të rehabilitohen vetëm subjektet e dënuara që kanë vuajtur efektivisht dënimin penal dhe jo ato që janë shmangur ekzekutimit të dënimit penal, siç është rasti i kërkuesit. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se kërkuesi nuk është i rehabilituar sipas nenit 69 të KP-së, për rrjedhojë konsiderohet i dënuar (*shih po aty paragrafët 76 dhe 78*).

39. Gjithashtu, GJKKO-ja e Apelit, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuesi më parë është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se në rastin konkret është akuzuar për kryerjen e veprës penale që prek zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve që, në thelb, është një vepër e cila cenon veprimtarinë shtetërore, ka vlerësuar se ai paraqet rrezik eminent për veprimtarinë e rregullt shtetërore dhe se ka dyshime të arsyeshme që ai mund të kryejë vepra penale ndaj shtetit (*shih po aty paragrafin 79*). Në këtë mënyrë, GJKKO-ja e apelit ka çmuar se plotësohen kumulativisht kushtet e posaçme të parashikuar nga pika 3 e nenit 228 të KPP-së (*shih po aty paragrafin 80*). Më tej, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se për faktin penal për të cilin akuzohet kërkuesi ekzistojnë rrethana rënduese, pasi vepra penale është kryer në bashkëpunim dhe duke shpërdoruar funksionin publik të kandidatit për kryetar të njësisë vendore, sipas nenit 50, shkronjat "dh" dhe "gj", të KP-së (*shih po aty paragrafin 82*). Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se plotësohen kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase sigurimi personal dhe se ajo (masa e sigurimit) duhet të ketë karakter paraburgosës, në mënyrë që të pamundësojë njëherazi helmimin e provave, rrezikun e ikjes dhe rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera në bashkëpunim ndaj shtetit. Në këto kushte, GJKKO-ja e Apelit, bazuar në nenin 230 të KP-së, ka arsyetuar se në kushtet kur nuk është në gjendje të sigurojë efektivisht dhe konkretisht asnjë masë tjetër sigurimi veç asaj "Arresti në burg", ka vlerësuar se masa e sigurimit personal më e përshtatshme për kërkuesin është ajo "Arresti në burg", e parashikuar nga neni 238 i KPP-së (*shih po aty paragrafin 83*).

40. Mbi rekursin e kërkuesit, disponimet e GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit janë vlerësuar të drejta edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Sipas këtij kolegji, referuar rrethanave të çështjes, nuk arrihet të zhbëhet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat (në përgjimet mjedisore) që kanë të bëjnë me premtimin për pagesë të zgjedhësve nga personi nën hetim (kërkuesi) dhe ekzekutimin e këtij premtimi nga personi tjetër nën hetim, shtetasi P.K., dhe se në stadin aktual nuk rezulton që pretendimet e rekursuesve të zhbëjnë dyshimin e arsyeshëm ndaj tyre për kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohen. Nga ana tjetër, Kolegji Penal ka vlerësuar se nga të dhënat të cilat të krijojnë dyshimin e arsyeshëm për kryerjen nga të hetuarit të aktit të dyshuar si kriminal, bazohen mbi veprimin e tyre, i cili ka të bëjë me dhënien prej tyre të parave personit të autorizuar nga prokuroria, në këmbim të votës së zgjedhësve të tjerë. Kështu, Kolegji Penal ka vlerësuar se ky është thelbi i faktit penal të dyshuar se është kryer nga të hetuarit, mbi të cilin ngrihet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen prej tyre të veprës penale për të cilën akuzohen (*shih paragrafët 107 dhe 109 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

41. Sipas Kolegjit Penal, kërkuesi paraqet rrezik për t'iu shmangur hetimit dhe për të kryer vepra të tjera më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, dhe ky rrezik nuk zhbëhet

me faktin se ai po kandidon për Bashkinë Himarë, për më tepër që nuk ka arritur të konstituohet si kryetar i kësaj njësie vendore (*shih paragrafin 116 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, sipas Kolegjit Penal, arsyetimi i bërë nga GJKKO-ja e Apelit lidhur me nenin 69 të KP-së për institutin e rehabilitimit është marrë në interpretim të drejtë të ligjit (*shih po aty paragrafin 117*). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, edhe nëse kërkuesi do të quhej i padënuar, sjellja e tij e mëparshme nuk mund të mos merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit të sjelljes së tij dhe vlerësimit të rrezikut të largimit, pasi është fakt i pamohueshëm që ai i është shmangur dënimit me burgim sipas evidentimit në rrethanat e çështjes dhe ky fakt është tregues i rëndësishëm në funksion të ekzistencës së rrezikut që ai të largohet (*shih po aty paragrafin 118*). Për këtë arsye, Kolegji Penal ka çmuar se në rastin konkret sjellja e mëparshme e kërkuesit nuk mund të mos merret në konsideratë në kuadër të çmuarjes së rrezikut të largimit, ose të kryerjes së veprave penale dhe se me të drejtë GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ka arsye të bazuara të cilat të çojnë në përfundimin e arsyeshëm se ai paraqet rrezik për t'u larguar, ashtu edhe për të kryer krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*shih po aty paragrafin 121*).

42. Po kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret rezulton i bazuar edhe vlerësimi i ekzistencës së rrezikut të marrjes ose i vërtetësisë së provës. Sipas Kolegjit Penal, pozita e personit nën hetim (kërkuesit) është e tillë që mund t'i intimidojë dëshmitarët e ardhshëm ose të kontribuojë në prishjen e provave dhe sipas të dhënave veprimtaria kriminale e dyshuar e tij mund të ketë përmasa më të gjera dhe përfshin edhe njësi të tjera administrative. Për rrjedhojë, Kolegji Penal ka çmuar se ka të dhëna të mjaftueshme dhe të rëndësishme për të konkluduar në ekzistencën e rrezikut të marrjes ose vërtetësisë së provës (*shih po aty paragrafin 122*). Për rrjedhojë, Kolegji Penal ka arritur në përfundimin se plotësohen të tria kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, duke konkluduar në këtë mënyrë në ekzistencën e nevojave të sigurimit dhe caktimin e një mase sigurimi (*shih po aty paragrafin 123*).

43. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, edhe pse kërkuesi me të drejtë ka parashtruar se nuk e ka kryer veprën duke shpërdoruar funksionin publik, sipas nenit 50, shkronja "dh", të KP-së, ky është tregues i rëndësisë së faktit penal, pasi ai dyshohet për kryerjen e një vepre penale që, për më tepër, prek zgjedhjet e lira nga një kandidat në zgjedhje dhe kjo tregon shpërdorim të besimit publik, duke i dhënë faktit penal një rëndësi të shtuar (në kuadër të dyshimeve) dhe autorit një rrezikshmëri të veçantë, duke bërë në këtë mënyrë të aplikueshëm parashikimin e pikës 1 të nenit 230 të KPP-së. Ky përfundim i Kolegjit Penal përforcohet edhe nga dyshimi i bazuar për ekzistencën e rrethanës së kryerjes së veprës penale në bashkëpunim (rrethanë rënduese e parashikuar nga shkronja "gj" e KP-së). Sipas Kolegjit Penal, nevojat e sigurimit në rastin e kërkuesit mund të kryhen vetëm nëpërmjet masës së sigurimit personal "Arresti në burg", për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, sikundër më lart është arsyetuar, dhe ai nuk paraqet rrethana nga ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 230 të KPP (*shih paragrafin 124 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

44. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vlerësimin e tyre për masën e sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar kufizimin e lirisë së tij, duke shfaqur një kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si edhe duke arsyetuar për "masën e duhur" të sigurimit personal dhe nëse ajo ishte e "mjaftueshme" për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Ato kanë analizuar rrezikun që paraqet kërkuesi për t'iu shmangur hetimit dhe për të kryer vepra të tjera më të rënda ose të të njëjtit lloj; sjelljen e mëparshme që ai ka pasur në të kaluarën, për shkak të personalitetit të tij dhe faktit se i është shmangur më parë dënimit me burgim dhe se ekziston mundësia e rrezikut që ai të largohet përsëri; ekzistencën e rrezikut të marrjes, të prishjes ose të vërtetësisë së provave, nëse ndaj kërkuesit nuk do të vendosej masa e sigurimit personal "Arresti në burg".

45. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar edhe rëndësinë e faktit, qoftë në drejtim të rrezikshmërisë së veprës penale, ashtu dhe të kërkuesit, si autor i dyshuar i saj, duke arritur në përfundimin se fakti penal ka një rëndësi të shtuar, përveçse kërkuesi paraqet rrezikshmëri të veçantë. Në këtë aspekt, gjykatat e në veçanti Gjykata e Lartë kanë evidentuar se vepra penale që dyshohet të jetë kryer në rastin konkret është një vepër që prek zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, që e kryer nga një kandidat në zgjedhje tregon për shpërdorimin e besimit publik. Një element tjetër i analizuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendosjen e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, është edhe fakti se ndaj tij ekziston dyshimi për kryerjen e veprës penale në rrethana rënduese, pikërisht kryerja e saj në bashkëpunim, ndërkohë që për atë nuk rezulton ndonjë rrethanë lehtësuese. Në vlerësimin e Gjykatës, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në faktet dhe informacionet e administruara rregullisht gjatë procesit, kanë analizuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga kërkuesi, sikundër edhe për ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, ato (gjykatat) kanë arsyetuar mjaftueshëm edhe në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit personal, duke parashtruar gjerësisht arsyet se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të masës "Arresti në burg" dhe vlerësuar njëkohësisht si të papërshtatshme çdo masë tjetër sigurimi personal.

46. Nisur nga sa më sipër, bazuar në standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se Kolegji Penal i ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesi dhe pasi i ka marrë në shqyrtim ato, i ka gjetur të pabazuara, duke vlerësuar, në thelb, se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e përfundimit të çështjes. Edhe për sa i përket pretendimit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e mbështet arsyetimin në një ngjarje të 20 vjetëve më parë, duke mohuar evolucionin e njeriut dhe të drejtën e tij për t'iu harruar e shkuara kur kalojnë afatet e parashikuara në ligj, Gjykata vëren se ai kolegj, duke iu referuar shmangies së kërkuesit nga kryerja e dënimit penal të dhënë ndaj tij me vendimet nr. 302, datë 18.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. 509, datë 26.12.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka arsyetuar se sjellja e mëparshme e tij nuk mund të mos merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit të sjelljes dhe vlerësimit të rrezikut të largimit (*shih paragrafët 116-118 të vendimit*). Në vlerësimin e Gjykatës, ky arsyetim, duke e vlerësuar personalitetin e tij në aspekt të ekzistencës së rrezikut që ai mund të largohet, si kriter i natyrës kushtetuese për proporcionalitetin e masës së arrestit në burg, nuk rezulton arbitrar.

47. Për sa më lart, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton i pamjaftueshëm, kontradiktor ose i paqartë, për rrjedhoje nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

48. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore është vendosur nga gjykatat e zakonshme për një qëllim të ligjshëm, që është garantimi i mbarëvajtjes dhe integritetit të procesit penal në ngarkim të tij. Po kështu, në vlerësimin e Gjykatës, masa e sigurimit personal "Arresti në burg" e vendosur ndaj kërkuesit nuk duket joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes, në raport të drejtë me veprën penale për të cilën ai akuzohet dhe rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg".

49. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit për vendosjen ndaj tij të masës së sigurimit personal, gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, me anë të të cilit i kanë cenuar edhe të drejtën për t'u zgjedhur, për shkak të kufizimit të lirisë personale. Si pasojë e vendosjes së masës "Arresti në burg" kërkuesi është vënë në pamundësi që të paraqitet personalisht

për kryerjen e betimit si kryetar i Bashkisë Himarë, i dalë fitues nga zgjedhjet vendore të vitit 2023, për rrjedhojë në pamundësi të ushtrimit të këtij mandati të fituar.

50. Gjykata vëren se e drejta për t'u zgjedhur garantohet nga neni 45 i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Kurse sipas nenit 109, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton se e drejta për t'u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit, që në rastin konkret është ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë, çka është e lidhur detyrimisht me bërjen e betimit në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak.

51. Për sa më lart, Gjykata konstaton se vendosja e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" në ngarkim të kërkuesit ka pamundësuar kryerjen e procedurës së betimit nga ana e tij si kryetar i zgjedhur i Bashkisë Himarë dhe, për pasojë, ajo (masa e arrestit) përbën një kufizim të së drejtës së kërkuesit për t'u zgjedhur. Sidoqoftë, duke qenë se Gjykata, ka arritur në përfundimin se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bërë për një qëllim të ligjshëm dhe se kufizimi nuk duket të jetë joproporcional në raport me këtë qëllim, ajo (Gjykata) çmon se edhe ndërhyrja në të drejtën për t'u zgjedhur nuk duket të jetë joproporcionale në raport me situatën që e ka bërë të nevojshme atë në rastin konkret. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me të drejtën për t'u zgjedhur është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

52. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur në raport me parimin e proporcionalitetit, të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 21.3.2024.
Shpallur, më 2.5.2024.

Kryetare: Holta Zaça
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Elsa Toska, Marjana Semini, Ilir Toska
Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Dhionisios Alfred Beleri, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore me të cilat është caktuar masa e sigurimit të arrestit në burg

ndaj tij, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar për shkak se të paktën një prej pretendimeve të kërkuesit ishte i bazuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Kërkuesi, i cili parashtron se i përket një pakice kombëtare (greke), ka kandiduar nga radhët e opozitës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.5.2023. Më datë 12.5.2023, dy ditë para ditës së votimit, ai është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP-së. Në vijim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe i kanë caktuar masën e sigurimit të arrestit në burg. Pas zhvillimit të zgjedhjeve kërkuesi është shpallur fitues për pozicionin e kryetarit të Bashkisë Himarë, megjithatë, për shkak të masës së sigurimit të arrestit në burg, ai nuk ka pasur mundësi të paraqitet në Këshillin Bashkiak për t'u betuar si kryetar i zgjedhur i bashkisë dhe, rrjedhimisht, as të ushtrojë detyrën.

3. Mbi këto fakte, kërkuesi ka pretenduar në thelb se masa e sigurimit të arrestit në burg nuk është proporcionale dhe se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, me anë të të cilit i kanë cenuar lirinë personale dhe të drejtën për t'u zgjedhur. Pretendimet e tij janë prapësuar si të pabazuara nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, me argumentet se kufizimi i lirisë së kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Kushtetutës dhe se e drejta për të ushtruar funksionin e kryetarit të bashkisë nuk mbizotëron në raport me interesin kushtetues të mbarëvajtjes së procedimit penal.

4. Sipas nenit 27 të Kushtetutës askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*). Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara në ligj dhe ky i fundit duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 39, datë 15.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Ndërsa e drejta për t'u zgjedhur parashikohet në nenin 45 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Kurse sipas nenit 109, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Ashtu siç ka vënë në dukje shumica, e drejta për t'u zgjedhur, e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit, që në rastin konkret është ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë, çka është e lidhur detyrimisht me bërjen e betimit në mbledhjen më të parë të Këshillit Bashkiak (*shih paragrafin 50 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se në rastet kur gjykimi kushtetues ka në objektin e tij kontrollin e lirisë personale dhe të drejtën për t'u zgjedhur, Gjykata duhet të përdorë kritere më të rrepta për vlerësimin se si garancitë kushtetuese janë zbatuar në praktikë. Këto kritere vlerësimi nuk mund të jenë të njëjta me ato që përdoren në kontrollin kushtetues të vendimeve të tjera gjyqësore. Ato janë më të rrepta për shkak se ndërlidhen me cilësinë e legjitimitetit demokratik të zgjedhjes së organeve kushtetuese, me rëndësinë jetike që ka liria personale e individit dhe me ndërthurjen organike që ekziston midis lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur, siç do të analizohet në vijim.

7. Për sa i takon legjitimitetit demokratik, kërkuesi ka parashtruar se i përket një pakice kombëtare dhe në procesin e zgjedhjeve vendore është shpallur fitues për pozicionin e kryetarit të

bashkisë, si kandidat i opozitës. Këto fakte të parashtruara prej tij lidhen me legjitimitetin demokratik të përfaqësimit të pakicës në organet kushtetuese të zgjedhura, ndaj Gjykata kishte detyrimin që çështjen ta vlerësonte bazuar në kritere objektive dhe që merrnin parasysh në mënyrë transparente jo vetëm rrethanat relevante të procedimit penal të kërkuesit, por, mbi të gjitha, edhe funksionin kushtetues që kërkuesi pritej të ushtronte në të ardhmen. Me fjalë të tjera, kriteret kushtetuese për kontrollin e çështjes duhet të ishin identifikuar sidomos nga perspektiva e kërkesave për funksionimin e përshtatshëm të Bashkisë Himarë, ku kërkuesi pritet të marrë pozicionin e kryetarit, institucion i cili është pjesë e sistemit kushtetues demokratik të vendit. Është fakt se për shkak të kufizimit të lirisë personale të kërkuesit Bashkia Himarë edhe sot është ende pa kryetar, duke sjellë në këtë mënyrë edhe deficit të legjitimitetit demokratik, pra deformim të vullnetit të qytetarëve që kanë votuar.

8. Lidhur me rëndësinë e lirisë personale dhe ndërhyrjen që arresti në burg bën ndaj saj, edhe vetë shumica ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me lirinë e personit (*shih paragrafin 33 të vendimit*). Megjithatë, një pohim i tillë mbetet teorik nëse nuk vihet theksi se pikërisht për këtë shkak Gjykata kur kontrollon masën e arrestit në burg përdor kritere më rigoroze vlerësimi të parimeve dhe standardeve kushtetuese. Thënë ndryshe, kur objekti i gjykimit kushtetues lidhet me garancitë kushtetuese procedurale (siç është edhe standardi i arsyetimit të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm), kriteret janë më të rrepta në raport me ato që përdoren gjatë kontrollit të vendimeve gjyqësore të tjera që japin gjykatat për zgjidhjen e çështjeve të paraqitura pranë tyre. Kjo e merr arsyen nga fakti se arresti në burg heq lirinë personale të individit, i cili ende nuk është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, kjo lloj mase sigurimi, në dukje, krijon përplasje me parimin e prezumimit të pafajësisë së individit, ndaj është masë me natyrë përjashtimore, që caktohet vetëm kur përmbushen kritere rigorozisht të përcaktuara nga ligji, që imponon njëherazi edhe detyrën për arsyetim rigoroz të gjykatave të zakonshme kur japin vendim për caktimin e saj.

9. Për sa i përket lidhjes që ka në rastin konkret liria personale me të drejtën për t'u zgjedhur, kërkuesi ka parashtruar se masa e sigurimit të arrestit në burg i ka hequr lirinë personale dhe si rezultat, ai është vendosur në pamundësi të kryerjes së betimit dhe marrjes së detyrës së kryetarit të bashkisë. Mbi këto fakte, shumica ka nxjerrë përfundimin se në kushtet kur *kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bërë për një qëllim të ligjshëm dhe nuk duket të jetë joproporcional në raport me këtë qëllim, atëherë edhe ndërhyrja në të drejtën për t'u zgjedhur nuk duket të jetë joproporcionale në raport me situatën që e ka bërë të nevojshme atë në rastin konkret (shih paragrafin 51 të vendimit).* Në këtë mënyrë, liria personale dhe e drejta për t'u zgjedhur janë vlerësuar nga shumica në raportin shka –pasojë, pra e drejta për t'u zgjedhur është konsideruar si e ndërvarur prej lirisë personale, ndaj vlerësimi kushtetues i shumicës ka pasur në objektin e tij vetëm kriteret kushtetuese që lidheshin me lirinë personale, duke mos i kushtuar vëmendje vlerësimit të së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur.

10. Megjithatë, duhet theksuar se ndërsa liria personale ka natyrë thellësisht vetjake, e drejta për t'u zgjedhur shtrin efektet e saj te zgjedhësit dhe legjitimiteti demokratik i organeve të zgjedhura, ndaj gjykimi kushtetues në rastin konkret duhet të orientohej sidomos në këtë drejtim. Për këtë arsye, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se çështja duhet të ishte analizuar duke ndërthurur standardet kushtetuese dhe konventore të të dyja këtyre të drejtave dhe lirive themelore të kërkuesit, me fokus të veçantë tek e drejta për t'u zgjedhur dhe duke identifikuar kritere kushtetuese të posaçme dhe rigoroze që i përshtateshin rastit konkret.

11. Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi dhe bazuar në nenet 17, 27 dhe 45 të Kushtetutës, për të vlerësuar nëse ndërhyrja që kërkuesi ka pësuar në lirinë personale dhe në të drejtën për t'u zgjedhur respekton kriteret kushtetuese dhe konventore të ndërhyrjes, duhet analizuar nëse ndërhyrja është bërë vetëm me ligj, për interes publik dhe nëse është në raport të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (kriteri i proporcionalitetit).

12. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi janë nxjerrë bazuar në nenet 228 e vijues të KPP-së, të cilat, në përputhje me nenin 27 të Kushtetutës, lejojnë që gjatë një procedimi penal të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ndaj individit që dyshohet të ketë kryer një vepër penale. Po ashtu, këto dispozita nuk parashikojnë ndonjë ndalim të shprehur për caktimin e arrestit në burg për individët që kandidojnë për t'u zgjedhur ose që zgjidhen. Për rrjedhojë, vlerësojmë se ndërhyrja në lirinë personale dhe të drejtën për t'u zgjedhur është bërë me ligj.

13. Për sa i takon interesit publik, ndajmë qëndrim të njëjtë me shumicën se caktimi i masës së arrestit në burg ka ndjekur një qëllim legjitim dhe se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar mjaftueshëm ekzistencën e fakteve ose informacioneve që kanë çuar në *dyshimin e arsyeshëm* për kryerjen e veprës penale të korrupsionit zgjedhor prej kërkuesit (*shih paragrafin 45 të vendimit*). Në këtë pikë, theksojmë se fenomeni i blerjes së votave është plagë e hershme e shoqërisë shqiptare që rrezikon integritetin e zgjedhjeve dhe se autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për ta luftuar atë para dhe gjatë fushatës zgjedhore.[1]

14. Në kushtet kur ndërhyrja në lirinë personale dhe në të drejtën për t'u zgjedhur është bërë me ligj dhe për një qëllim legjitim, ajo që mbetet për t'u përcaktuar është nëse caktimi i masës së sigurimit të arrestit në burg ndaj kërkuesit është proporcionale, pra nëse është në raport të drejtë me nevojën për të garantuar mbarëvajtjen dhe integritetin e procedimit penal që po zhvillohet ndaj tij. Me fjalë të tjera, duhet analizuar nëse masa e sigurimit e arrestit në burg, e cila është përdorur si mjet për të arritur qëllimin legjitim ka qenë: (i) *e përshtatshme*, në kuptimin se sa e arsyeshme ka qenë kjo masë duke analizuar interesat dhe të drejtat që konkurrojnë me njëra-tjetrën; dhe (ii) *e nevojshme*, në kuptimin nëse masa ka mundësinë të arrijë qëllimin legjitim, atë të sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal.

15. Në parantezë të analizës së proporcionalitetit të masës, vëmë në dukje se nuk qëndron argumenti i kërkuesit që lidhet me procedime të tjera penale për korrupsion zgjedhor, në të cilat ndaj të dyshuarve nuk është caktuar masa e sigurimit e arrestit në burg. Duke theksuar edhe një herë rëndësinë kritike që kanë përpjekjet për të luftuar realisht fenomenin e blerjes së votës para dhe gjatë fushatës zgjedhore, vlerësojmë se argumenti i kërkuesit tenton të barazojë situata paligjshmërie, të cilat nuk gëzojnë mbrojtje as nga Kushtetuta, as nga ligji.

16. Duke iu kthyer analizës së proporcionalitetit, shumica, me të drejtë, ka evidentuar jurisprudencën e GJEDNJ-së për nenin 5 të KEDNJ-së *(shih paragrafin 30 të vendimit*), sipas së cilës rreziku i largimit duhet të vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal *(shih Becciev kundër Moldavisë, datë 4.10.2005, §§58–59*). Rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale është një ndër shkaqet që mund të bindin autoritetet gjyqësore që të vendosin dhe lënë në paraburgim një të dyshuar. Megjithatë është e nevojshme që rreziku të jetë i besueshëm nën dritën e rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit. Dënimet e mëparshme mund të shërbejnë si shkas për të besuar në mënyrë të arsyeshme se i akuzuari mund të kryejë vepra penale të tjera (*shih Selc'uk kundër Turqisë, datë 10.1.2006, §34*). Sipas GJEDNJ-së, këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i autoriteteve për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip (*shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë, [DhM], datë 28.11.2017, §222*). Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vendimi i saj nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 5/3 të KEDNJ-së, do të merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §§89–91*).

17. Në këtë drejtim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se arresti në burg është masa e sigurimit më e përshtatshme, duke vënë theksin te rreziku i ikjes së kërkuesit dhe shmangies

[1] Shih rekomandimet parësore të Raportit Përfundimtar të Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të datës 14 maj 2023 – https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf

së tij nga hetimi penal; te ndikimi i tij në marrjen e provave; te mundësia për të kryer vepra të tjera penale, duke i lidhur këto me personalitetin e kërkuesit, për shkak se gjatë një procedimi penal të mëparshëm për dënimin e tij, ai i ishte fshehur drejtësisë. Në lidhje me këto argumente të gjykatave të zakonshme, shumica ka konkluduar se ato përbëjnë arsye të mjaftueshme për justifikimin e kufizimit të lirisë së kërkuesit dhe se gjykatat e zakonshme kanë shfaqur kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si dhe kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me "masën e duhur" të sigurimit personal dhe nevojën që ajo të arrinte qëllimin e kërkuar (*shih paragrafin 44 të vendimit*).

18. Në mendimin tonë, masa e sigurimit personal e arrestit në burg, që është caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë e *përshtatshme*. Fillimisht vëmë në dukje se, në zbatim të detyrimeve kushtetuese që burojnë nga neni 27 i Kushtetutës, KPP-ja parashikon qartësisht se arresti në burg caktohet kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme (*neni 230, pika 1*) dhe se gjykata kur cakton këtë masë ka detyrimin të arsyetojë papërshtatshmërinë e masave të tjera (*neni 245, pika 1, shkronja "ç"*). Në rastin konkret, gjykatat e zakonshme nuk rezultojnë ta kenë përmbushur një detyrim të tillë, pasi në caktimin e masës së arrestit në burg ndaj kërkuesit nuk kanë arsyetuar për ekuilibrin që duhet të ekzistojë midis të drejtave kushtetuese të kërkuesit dhe interesit për mbarëvajtjen e procedimit penal ndaj tij dhe se përse masat e tjera të sigurimit nuk mund të përmbushnin qëllimin legjitim. Pa vënë në dyshim interesin publik për mbarëvajtjen e procedimeve penale, sidomos të atyre që lidhen me çështje të korrupsionit zgjedhor, ritheksojmë se në çështjen konkrete janë vënë në diskutim jo vetëm liria personale e kërkuesit, por edhe e drejta për t'u zgjedhur dhe cilësia e legjitimitetit demokratik në Bashkinë Himarë, e cila ende sot e kësaj dite vijon të jetë pa kryetar të zgjedhur në mënyrë demokratike. Ndërkohë gjykatat e zakonshme, jo vetëm që nuk e kanë analizuar të plotë situatën, pra edhe nga perspektiva e së drejtës për t'u zgjedhur dhe cilësisë së legjitimitetit demokratik në njësinë bashkiake Himarë, por kanë shkuar në drejtimin e kundërt. Kështu, ato kanë arsyetuar se shpallja fitues e kërkuesit nuk përjashton rrezikun e ikjes së tij, në kushtet kur ai ende nuk e ka marrë detyrën (*shih paragrafin 116 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), duke anashkaluar me këtë arsyetim faktin se pengesa për marrjen e detyrës lidhej pikërisht me arrestin në burg.

19. Për sa i takon kriterit se sa *e nevojshme* ka qenë masa e sigurimit të arrestit në burg ndaj kërkuesit për të arritur mbarëvajtjen e procedimit penal, jemi të mendimit se arsyetimi i gjykatave të zakonshme në çështjen konkrete përmban gabime të dukshme në këtë drejtim. Konkretisht, arsyetimi i gjykatës së apelit, i përkrahur edhe nga Gjykata e Lartë, se kërkuesi paraqet rrezik ikjeje, pasi ai i është shmangur në vitin 2006 një procedimi penal, për të cilin është shpallur fajtor dhe dënuar me tre vjet burgim, bie ndesh, në pamje të parë, me vetë formulimin ligjor të nenit 69 të KP-së, i cili parashikon se me kalimin e afateve ligjore, individi quhet i padënuar. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë se edhe nëse kërkuesi do të quhej i padënuar, sjellja e tij e mëparshme nuk mund të mos merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit të sjelljes së tij dhe vlerësimit të rrezikut të largimit, pasi është fakt i pamohueshëm se ai i është shmangur dënimit me burgim sipas evidentimit në rrethanat e çështjes dhe ky fakt është tregues i rëndësishëm në funksion të ekzistencës së rrezikut që ai të largohet (*shih paragrafin 118 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), nuk duket logjik. Ky argument, që ka rënduar pozitën e kërkuesit, i jep më tepër rëndësi sjelljes së individit në procedurat përpara gjykatave, të cilat nuk sanksionohen nga ligji, se sa sjelljes së individit në kryerjen e veprës penale, të sanksionueshme me dënim me burgim. Nga ana tjetër, konkluzioni i gjykatave se kërkuesi paraqet rrezik të largohet, nuk i përgjigjet situatës së fakteve të çështjes, pasi kërkuesi pas përfundimit të zgjedhjeve ka rezultuar fitues i pozicionit të kryetarit të bashkisë dhe nuk do të kishte ndonjë interes të tillë në atë drejtim.

20. Po ashtu, edhe argumentet se ka rrethana nga të cilat krijohet vlerësimi se ka rrezik eminent që liria e pakushtëzuar e kërkuesit mundet të helmojë provat ose të riskojë gjetjen dhe fiksimin e gjendjen natyrore të tyre, apo që pozita e tij është e tillë që mund t'i intimidojë dëshmitarët e ardhshëm, apo të kontribuojë në prishjen e provave, nuk duket të jetë korrekte dhe në përputhje me dispozitat procedurale penale. Këto të fundit kanë përcaktuar se kur vihet në rrezik marrja e

provave, masa e sigurimit caktohet me afat (*neni 245 i KPP-së*) dhe jo pa afat, siç ka ndodhur në rastin e kërkuesit, që faktikisht e ka penguar atë të marrë detyrën e kryetarit të bashkisë. Ndërsa konkluzioni i gjykatave se sipas të dhënave veprimtaria kriminale e dyshuar e tij mund të ketë përmasa më të gjera dhe përfshin edhe njësi të tjera administrative nuk është konkretizuar nga pikëpamja faktike. Në këtë mënyrë, është e paqartë nëse bëhet fjalë për të dhënat që mbështesnin dyshimin e arsyeshëm që ekzistonte në kohën e caktimit të arrestit në burg, siç lejon ligji, apo për konkluzion përgjithësues të gjykatave të zakonshme, që në vetvete përbën paragjykim të papërshtatshëm për personalitetin e kërkuesit, të palejuar nga ligji.

21. Gjithashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkuesi dyshohet të ketë shpërdoruar funksionin publik të kandidatit në zgjedhje, arsyetim i cili është korrigjuar nga Gjykata e Lartë me argumentin se edhe pse kërkuesi nuk ka pasur funksion publik, ai dyshohet për kryerjen e një vepre penale, për më tepër që prek zgjedhjet e lira nga një kandidat në zgjedhje dhe kjo tregon shpërdorim të besimit publik, duke i dhënë faktit penal një rëndësi të shtuar (në kuadër të dyshimeve) dhe autorit një rrezikshmëri të veçantë që justifikon caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg (*shih paragrafin 124 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kjo rrethanë duket se ka ndikuar në llojin e masës së sigurimit të arrestit në burg, sepse është vlerësuar si rrethanë e veçantë rënduese. Megjithatë, edhe pas korrigjimit të saj nga Gjykata e Lartë, është e paqartë nëse ajo është vlerësuar dy herë prej gjykatave të zakonshme, duke rënduar në mënyrë të papërshtatshme pozitën e kërkuesit, një herë si element i figurës së veprës penale të korrupsionit zgjedhor dhe një herë tjetër si rrethanë e veçantë rënduese.

22. Thënë sa më lart dhe duke përdorur kritere më rigoroze kontrolli për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për shkak se çështja konkrete ndërlidhet me cilësinë e legjitimitetit demokratik të zgjedhjes së organeve kushtetuese, me rëndësinë jetike që ka liria personale e individit dhe me ndërthurjen organike që ekziston midis lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur, arrijmë në përfundimin se gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar mjaftueshëm për proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit të arrestit në burg ndaj kërkuesit. Në këtë mënyrë, procesi i caktimit të masës së sigurimit të arrestit në burg nuk ka përmbushur qëllimin kushtetues të parandalimit të heqjes së pajustifikuar të lirisë, duke cenuar njëkohësisht edhe të drejtën për t'u zgjedhur. Caktimi i masës së sigurimit të arrestit në burg dy ditë përpara ditës së votimit për zgjedhjet vendore dhe vazhdimi i kësaj mase, që e ka penguar atë në fakt të marrë detyrën e kryetarit të bashkisë, si pasojë e prezumimit të korrupsionit në zgjedhje, duhej vlerësuar arbitrare për shkak të mungesës së garancive të mjaftueshme procedurale. Për rrjedhojë, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur, në raport me parimin e proporcionalitetit, të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi ishte i bazuar, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari